
Republika e Shqiperise
Komisioni i Letrave me Vlere

RAPORTI VJETOR

2002

Permbajtja e Lendes

Ngjarje Kryesore	3
Informacion i Pergjithshem mbi Komisionin e Letrave me Vlere	4
Bordi i Komisionereve te Komisionit te Letrave me Vlere	6
Struktura Organizative e Komisionit te Letrave me Vlere	7
1. Legjislacioni	8
2. Aktiviteti i Licensimit, Monitorimit dhe Disiplinimit	10
2.1 Licensimi i Subjekteve	10
2.2 Licensimi Provizor i Tregut	11
2.3 Licensimi i Rregjistrit	11
2.4 Disiplinimi	12
3. Bashkepunimi Nderkombetar	13
3.1 Bashkepunimi me IOSCON	13
3.2 Bashkepunimi me Komisionet Analoge dhe Institucionet e tjera	14
3.3 Grupi Konsultativ	15
3.4 Marreveshjet e Mirekuptimit	15
3.5 Asistenca Teknike	16
3.6 Pjesemarrja e KLV ne Seminare, Konferenca e Programe Trainimi	17
3.7 Aktiviteti Publikues	18
4. Zhvillimi i Tregut gjate vitit 2002	19
5. Plani i Aktiveteve te Komisionit te Letrave me Vlere gjate 2003	21
6. Buxheti i KLV ne vitin 2002	22
7. Shtojca	25

NGJARJET KRYESORE TE VITIT

**KOMISIONI I LETRAVE ME
VLERE, NE MBLEDHJEN E
DATES 5.11.2002, VENDOSI
DHENIEN E LICENSES
PROVIZORE SHOQERISE
BURSA E TIRANES sh.a PËR
TE OPERUAR SI TREG
LETRASH ME VLERE**

**KOMISIONI I
LETRAVE ME VLERE
MERR PJESE ME
STATUSIN E
VEZHguesIT NE
MBLEDHJEN E GRUPIT
KONSULTATIV**

Informacion i Pergjithshem mbi Komisionin e Letrave me Vlere

Komisioni i Letrave me Vlere (KLV) i Republikes se Shqiperise, eshte krijuar ne baze te Ligjit nr. 8080, date 1.3.1996 "Per Letrat me Vlere", modifikuar nga Ligji No. 8168 dt. 5.12.1996 dhe Ligji No.8745 dt 22.02.2001 "Për disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin 8080". KLV eshte autoriteti i vetem rregullator i Tregut te Letrave me Vlere qe zhvillon veprimtarine e tij ne territorin e Shqiperise.

Komisioni perbehet nga shtate Komisionere te cilet miratohen nga Kuvendi Popullor. Komisioni mblidhet ne takime te rregullta, ku merren vendime, percaktohen prioritetet, diskutohet per programet ne vazhdimesi dhe ato te perspektives.

Duke ndjekur ecurine e zhvillimeve ekonomike dhe sociale ne Shqiperi, angazhimin e Qeverise dhe te sektorit privat per hapjen e Burses se Tiranes, objektivi kryesor i planit te punes te Komisionit te Letrave me Vlere per vitin 2002, ka qene pergatitja per hapjen e tregut te kapitaleve dhe kryesisht detyrat qe mbulojne dhe ndihmojne procesin e licensimit te tregut te letrave me vlere.

Gjate vitit 2002, KLV ka vazhduar te punoje intensivisht ne ngritjen e nje baze ligjore bashkekohore, duke patur si qellimin me te larte mbrojtjen e investitoreve.

KLV, gjate ketij viti, si i vetmi autoritet rregullator i tregut te letrave me vlere ne vend, ka bere perpjekje per ndergjegjesimin si te vendim marresve ashtu dhe te pjesemarresve potenciale ne treg, ne krijimin e nje koncepti te drejte mbi rolin e tregut te letrave me vlere ne ekonomi.

Komisioni financohet nga Buxheti i Shtetit me subvencion per nje periudhe kohe derisa te funksionojë si institucion i pavarur ku pagimi i kuotave dhe detyrimeve te tjera ndaj Komisionit do te jene te mjaftueshme per funksionimin e tij.

Funksionet e Komisionit te Letrave me Vlere jane si vijon:

♦ Licenson, vëzhgon dhe mbikqyr veprimtarine e tregjeve te letrave me vlere si dhe te ofruesve te sherbimeve te pastrimit dhe te rregullimit te transaksioneve te letrave me vlere, te depozitareve te letrave me vlere;

♦ licenson, mbikqyr dhe vëzhgon veprimtaritë e tregtarëve, këshilltarëve të investimeve, përfaqësuesve të tyre përkatës, drejtuesve të investimeve, fondeve të letrave me vlerë të licencuar;

- ◆ miraton statutin dhe rregullat e shoqërive të licencuara për të vepruar si treg i letrave me vlerë ose për të kryer shërbime të pastrimit dhe të rregullimit të transaksioneve të letrave me vlerë, depozitarëve e regjistruarve të letrave me vlerë, si dhe të fondeve të letrave me vlerë;
- ◆ vëzhgon dhe vendos rregullat për drejtimin e të licencuarve, duke përfshirë revokimin dhe pezullimin e licencave;
- ◆ nxit dhe inkurajon standarde të larta për mbrojtjen e investitorëve dhe integritetin ndërmjet të licencuarve;
- ◆ mbështet funksionimin e tregut të letrave me vlerë në mënyrë të rregullt, të hapur dhe të informuar siç duhet;
- ◆ ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm për të mbrojtur interesat e investitorëve dhe ndalon veprimet e paligjshme, të pandershme dhe të papërshtatshme lidhur me tregtimin e letrave me vlerë;
- ◆ ushtron dhe përmbush të drejta dhe detyra të tilla që i akordohen apo vendosen mbi të;
- ◆ u miraton, ndryshon, pezullon dhe shfuqizon rregulla dhe urdhra të tillë siç autorizohen, ose si të përshtatshme për t'u plotësuar nga ky ligj dhe mund të përcaktojë termat e përdorura në këtë ligj në mënyrë që të përputhen me aktet e tij. Ai ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar përputhjen e këtij ligji me çdo rregull të vendosur në bazë të tij;
- ◆ mbikqyr mënyrën e tregimit dhe llojin e letrave me vlerë që tregtohen në tregun përkatës dhe miraton rregullat e tregut të letrave me vlerë lidhur me anëtarësinë, listimin, pjesëmarrjen minimale, mjaftueshmërinë e kapitalit, shpalljet, raportimet periodike, raportimet për të gjithë transaksionet si dhe pastrimin e llogarive e rregullimin e transaksioneve;

Per përmbushjen e misionit të ngarkuar me ligj, KLV ka ngritur administratën e tij, e cila është e detyruar të zbatojë të gjitha vendimet e marra dhe detyrat e caktuara në mbledhjet e Komisionit. Organet drejtuese të administratës së Komisionit janë Bordi i Komisionerëve dhe Drejtori Ekzekutiv i Administratës së KLV.


Komisioni ndjek një politikë punësimi të kujdesshme e të qëndrueshme. Kjo bëhet përmes zgjedhjes së personelit bazuar në cilësitë profesionale, kualifikimeve dhe eksperiencës së tyre.

Perberja e Bordit te Komisionit

Fatos Reca	Kryetar
Rexhina Nano	Nen Kryetare
Adrian Fullani	Komisioner
Elisabeta Gjoni	Komisionere
Keler Gjika	Komisioner
Manjola Naco	Komisionere
Marjan Gjermeni	Komisioner

Keto jane anetaret e Bordit te Komisionit ne kohen e publikimit te ketij raporti

Struktura Organizative e Komisionit te Letrave me Vlere



1. Legjislacioni

Plotesimi dhe permiresimi i kuadrit ligjor te tregut te letrave me vlere ne perputhje me standartet nderkombetare, ka qene fokusi kryesor i aktivitetit te KLV. Ne mbeshtetje te ketij objektivi kane sherbyer parimet e IOSCOs, Direktivat e Europes dhe eksperienca e tregjeve me te zhvilluara te letrave me vlere.

Gjate vitit 2002 zhvillimet ne legjislacion per tregun shqiptar te kapitaleve konsistojne ne vendimet e rendesishme te Komisionit per miratimin e draft rregulloreve lidhur me funksionimin e tregut te letrave me vlere.

Si arritje kryesore ne fushen e legjislacionit per tregun e letrave me vlere gjate ketij viti, mund te permendim:

Gjate muajit shkurt 2002, Komisioni aprovoi *Rregulloren “Mbi organizimin e provimit te individeve qe kerkojne te pajisen me license si perfaqesues tregtari”*. Kjo Rregullore percakton autoritetin e Komisionit per organizimin dhe mbikqyrjen e provimit te ketyre individeve nepermjet krijimit te Komitetit te Provimit, ne zbatim te pikes 2, neni 33 i Ligjit Nr. 8080, date 01.03.1996 “Per Letrat me Vlere”, ndryshuar me Ligjin Nr. 8168, date 05.12.1996 dhe me Ligjin Nr. 8745, date 22.02.2001. Rregullorja vendos norma ne lidhje me perberjen e Komitetit, kompetencat e tij, individet qe i nenshtrohen provimit, permbajtjen e tezes se provimit, proceduren e organizimit te tij, afatin e korrigjimit dhe nxjerrjes se rezultateve te provimit dhe te drejten per perseritjen e tij.

Ne daten 17.06.2002, Komisioni miratoi *Rregulloren “Per licencimin e tregut te letrave me vlere”*. Rregullorja ka si objekt percaktimin e kerkesave, afateve dhe procedurave te licencimit, te cilat duhen ndjekur nga subjektet qe aplikojne per t’u pajisur me licence per te vepruar si treg letrash me vlere. Rregullorja parashikon marrjen e licences ne dy faza. Gjate fazes se pare, aplikanti dorezon prane Komisionit dokumentacionin qe permban aktin e themelimit te shoqerise, statutin, emerimin e drejtuesve dhe anetareve te bordit, si dhe te dhena per vendin ku do zhvilloje veprimtarine. Me plotesimin e ketyre kerkesave, Komisioni akordon licencen provizore.

Brenda gjashte muajve nga miratimi i licences provizore, Tregu i Letrave me Vlere duhet te paraqese per miratim prane Komisionit nje sere dokumentash te tjera qe lidhen me menyren e funksionimit te tregut dhe venien e tij ne gadishmeri. Keto dokumenta perfshijne: Rregullat e funksionimit te tregut, sigurimin e pajisjeve te nevojshme per

tregtim, lidhjen e marreveshjeve me anetaret dhe ofruesit e shërbimeve të pastrimit e regjistrimit të transaksioneve, etj. Plotësimi i këtyre kërkesave shënon marrjen e licencës përfundimtare.

Gjatë vitit 2002, KLV ka punuar për përgatitjen e *projekt rregullore "Mbi Licensimin e Tregtarit të Letrave me Vlerë dhe përfaqësuesit të tij"*. Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të përmbledhë në një rregullore të vetme të gjithë procedurën që nga momenti i dorëzimit të dokumentacionit duke vazhduar me refuzimin ose dhenien e licencës tregtarit të letrave me vlerë dhe përfaqësuesit të tij, si dhe me ndryshimet që i ndodhin kësaj license deri në momentin kur përfundon vlefshmeria e saj. Mund të ketë persëritje nga ligji ose rregullore të tjera por kjo është bërë për të përqendruar në një rregullore njëqind rregulla që lidhen me të ose për të detajuar rregullat të cilat në rregullore të tjera ose në ligj kanë nevojë që të interpretohen. Kjo rregullore pritet që të aprovohet në fillim të vitit të ardhshëm.

KLV gjatë këtij viti ka filluar punën për përgatitjen e *projekt rregullore "Për vlerësimin e punonjësve dhe kriteret e marrjes në punë"*. Kjo rregullore pritet të përfundojë gjatë vitit të ardhshëm.

2. Aktiviteti i Licensimit, Monitorimit e Disiplinimit

Nje nga funksionet e rendesishme te Komisionit eshte edhe Licensimi i subjekteve qe operojne ne tregun e letrave me vlere. KLV gjate vitit 2002 ka shqyrtuar nje numer te madh kerkesash për Licensim për te operuar ne tregun shqiptar te kapitaleve.

2.1 Licensimi i subjekteve

Gjate vitit 2002, Komisioni i ka rinovuar Licensen si tregtar për Bono Thesari ne Burse subjekteve te meposhtme banka dhe institucione jo-bankare dhe perfaqesuesve te tyre tregtare.

- ▶ INSIG
- ▶ Banka Kombetare Greke (dega e Tiranes 559) (janar 2002) dhe zevendesimin e perfaqesuesve te saj tregtare per shkak te largimit nga Shqiperia;
- ▶ Banka e Kursimeve si tregtar ne bono thesari dhe e relacioneve per Komisionin;
- ▶ Banka Kombetare Tregtare;
- ▶ Banka Italo-Shqiptare;
- ▶ Banka Amerikane te Shqiperise;
- ▶ “Ballkan – Group 01” si tregtar ne bono thesari;
- ▶ Tirana Bank (mbas nje nderprerje 2 vjecare);

Komisioni gjate ketij viti ka dhene për here te pare licensen si tregtar për Bono Thesari ne Burse shoqerise tregtare FEFAD Bank.

Numri i subjekteve dhe i perfaqesuesve te tyre te licensuar për here te pare dhe rinovimi i licensave si tregtar për Bono Thesari ne Burse, sipas viteve paraqitet si ne tabelë:

Vitet	Aplikime te reja	Licensa te reja te dhena	Rinovim licensash	Nr. total i licensave te dhena	Nr. total i perf te licensuar
1996	7	6	-	6	9
1997	3	1	6	7	14
1998	3	2	4	6	14
1999	2	2	5	7	12
2000	2	2	6	8	12
2001	1	1	-	1	2
2002	2	1	8	9	15

2.2 Licensimi Provizor i Tregut

Ne Nentor 2002, mbeshtetur ne dokumentacionin e paraqitur dhe ne perputhje me kerkesat e Rregullores Nr. 6/1, date 17.06.2002 “Per licensimin e tregut te letrave me vlere”, Komisioni i Letrave me Vlere, vendosi dhenien e licenses provizore shoqerise Bursa e Tiranes sh.a. per te operuar si treg letrash me vlere. Procedurat e licensimit perfundimtar do t’i nenshtrohen dispozitave te Ligjit No.8080 dhe te Rregullores Nr. 6/1, date 17.06.2002 “Per licensimin e tregut te letrave me vlere”.

Shoqeria Bursa e Tiranes sh.a. eshte themeluar ne formen e shoqerise anonime pa oferte publike dhe eshte rregjistruar si person juridik ne Gjykatën e Rrethit Tirane, me Vendimin Nr.27324, date 06.03.2002. Objekti i veprimtarise se saj perputhet plotesisht me perkufizimin e dhene per tregun e letrave me vlere ne Nenin 2 te Ligjit Nr.8080, date 01.03.1996 “Per Letrat me Vlere”, ndryshuar me Ligjin Nr. 8168, date 05.12.1996 dhe me Ligjin Nr. 8745, date 22.02.2002. Kapitali themeltar i Burses se Tiranes sh.a. eshte 20 milion leke, i teri ne pronesi te shtetit (pronar eshte Ministria e Financave). Shoqeria Bursa e Tiranes sh.a. drejtohet nga nje Keshill Mbikqyres dhe Drejtori i Pergjithshem.

2.3 Licensimi i Rregjistrimit

Gjate vitit 2002, Komisioni i Letrave me Vlere pasi shqyrtoi kerkesen e bere nga Shoqeria “Qendra e Rregjistrimit te Aksioneve” sh.a. aprovoi dhenien e Licenses kesaj shoqerie, si Rregjistrues i Aksioneve.

Shoqeria Qendra e Rregjistrimit te Aksioneve (QRA) sh.a eshte krijuar dhe funksionon ne baze te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.112, date 19.02.1996 “Per krijimin e shoqerise anonime shteterore”. “Qendra e Rregjistrimit te Aksioneve” eshte rregjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr.14253, date 21.03.1996. QRA-ja eshte shoqeri anonime pa oferte publike, ne te cilen te gjitha aksionet zoterohen nga shteti. Ajo u krijua si nje institucion i pavarur dhe i specializuar per te mbajtur regjistrin e aksioneve te shoqerive private anonime te krijuara si rezultat i programit te privatizimit masiv ne Shqiperi.

QRA-ja funksionon mbi bazen e disa Rregulloreve te brendshme. Aktualisht, nga shoqerite anonime te krijuara ne Shqiperi, kryesisht si rezultat i programit te privatizimit masiv, nga 122 sh.a te detyruara nga ligji te mbajne regjistrin e aksionereve te tyre ne QRA vetem 82 prej tyre aktualisht e zbatojne kete. Gjate ketyre viteve te aktivitetit te

QRA-se, numri dhe cilesia e shoqerive qe kane zbatuar ligjin dhe kane bere kontrate me QRA-ne eshte rritur dhe QRA-ja ka treguar se ka qene e afte te mbuloje shpenzimet e saj. Duke u bazuar ne dokumentacionin e paraqitur, ne verifikimin ne vend te te dhenave mbi pajisjet, hapesirat qe do te perdoren per veprimtarine per te cilen kerkohet licensa, dhe ballafaqimin e tyre me kerkesat e Rregullores Nr.9/1, date 30.10.2001 “Mbi Licensimin e Regjistruesve te Letrave me Vlere”, Komisioni aprovoi dhenien e Licenses si Regjistrues i Aksioneve kesaj shoqerie.

2.4 Disiplinimi

Gjate vitit 2002 Komisioni konstatoi se shoqeria Leil-K sh.p.k. kryente aktivitet te palicensuar per mbajtje rregjistri aksionesh duke shkelur nenin 29 paragrafi 1 te Ligjit "Per Letrat me Vlere" nr. 8080 date 1.3.1996, ndryshuar me Ligjin nr.8168 date 5.12.1996 dhe me Ligjin nr.8745 date 22.02.2001.

Per kete arsye, Komisioni i Letrave me Vlere vendosi:

Gjebitjen e shoqerise tregtare “Leil-K” sh.p.k. ne shumen prej 50.000 leke;

Pezullimin e menjehershem te aktivitetit te mbajtjes se regjistrimit te aksioneve te shoqerive anonime dhe fillimin e procedurave perkatese nga ana e shoqerise per licencimin e ketij aktiviteti ne perputhje me ligjin “Per Letrat me Vlere” dhe Rregulloren “Mbi Licencimin e Regjistruesve te Letrave me Vlere”.

Moszbatimi i ketij vendimi, coi ne ngritjen e padise nga Komisioni ndaj shoqerise per pagimin e gjobes dhe prishjen me nenvizim te aktivitetit te regjistrimit te aksioneve.

3. Bashkepunimi Nderkombetar

Ne kushtet e liberalizimit te tregjeve boterore te kapitalit, eshte rritur edhe rendesia e bashkepunimit për standartet nderkombetare, ligjet, rregulloret dhe procedurat e tregjeve te kapitalit ne bote.

KLV gjate vitit 2002 ka punuar për forcimin e lidhjeve te tij me autoritete te ngjashme, institucione dhe organizata nderkombetare te tregjeve te kapitalit, duke nxitur ne kete menyre koordinimin, shkembimin e informacionit dhe integrim sa me te shpejte.

3.1 Bashkepunimi me IOSCO

KLV eshte anetar i Organizates Nderkombetare te Komisioneve te Letrave me Vlere (IOSCO) qe nga viti 1998 - organizate qe perbehet nga institucione qe mbikqyrin tregjet e kapitalit ne bote. Komisioni eshte gjithashtu anetar i Komitetit te Tregjeve ne Zhvillim (Emerging Markets Committee) te kesaj organizate.

Komisioni, për arritjen e objektivave te tij, ka bashkepunuar ngushtesisht me IOSCO si pjese e strukturave te tij, duke mbajtur nje komunikim te vazhdueshem ne lidhje me probleme te ndryshme.

Keshtu, KLV gjate ketij viti ka marre pjese ne aktivitetin e IOSCOs me plotesimin e pyetesoreve te ndryshem qe synojne standartizimin e legjislacioneve midis vendeve te ndryshme anetare, si dhe me pjesemarrjen aktive ne mbledhjen vjetore te organizuar nga kjo organizate dhe komitetet qe veprojne brenda saj. Nder pyetesoret e derguar gjate ketij viti nga IOSCO mund te permendim Pyetesorin për Marreveshjen Multilaterale dhe Pyetesorin mbi Programet Trainuese.

Ne Maj 2002, KLV mori pjese ne Konferencen e 27 Vjetore te IOSCO-s qe u zhvillua ne Turqi. Ne kete Konference u mblodhen rregullatore, pjesemarres tregu dhe te tjere për te diskutuar mbi temen: "Globalizimi: Oportunitete dhe Sfida". Trajtimi i kesaj teme mendohej te sillte mundesi te reja për investitorët dhe siguruesit e sherbimeve financiare dhe sfida te reja për rregullatorët e sherbimeve financiare. Komisioni mori pjese ne mbledhjet e Komiteteve te kesaj organizate, ku u raportua nga grupet e punes se tyre ne lidhje me ceshtje te ndryshme qe trajtonin probleme me te cilat perballen rregullatorët neper bote.

3.2 Bashkepunimi me Komisionet Analoge dhe me Institucionet e tjera

Gjate ketij viti KLV ka shkëmbyer vizita pune me Autoritete te ngjashme ne bote, aktiviteti i te cilave eshte i lidhur me tregjet e kapitalit ne bote. Keto vizita pune i kane sherbyer shkembimit te eksperiences dhe rrahjes se mendimeve me keto Autoritete për ceshtje te ndryshme ne lidhje me zhvillimin e tregut te kapitaleve.

Keshtu, ne Janar 2002, nje delegacion i kryesuar nga Kryetari i KLV kreu nje vizite pune prane CONSOB-it (Komisionit Italian te Shoqerive dhe Burses). Ndersa perfaqesues te ketij Autoriteti erdhen për vizite pune prane KLV ne Shtator 2002.

Gjate vitit 2002 eshte pergatitur vizita e punes qe KLV do te zhvilloje ne fillim te vitit te ardhshem prane Komisionit Maqedon te Letrave me Vlere dhe Burses.

Keto vizita ishin mjaft te rendesishme ne identifikimin e mundesive për bashkeveprim e shkembim eksperience me vendet e tjera, nga pikepamja e zhvillimeve legjislative dhe proceduriale.

Ne kuadrin e bashkepunimit me institucione te tjera brenda vendit, ne Mars 2002, Komisioni i Letrave me Vlere nenshkroi nje Marreveshje Mirekuptimi me Fakulteti Ekonomik i Universitetit te Tiranes (FEUT). Kjo Marreveshje synon te siguroje asistence reciproke ne drejtim te shkembimit te informacionit dhe bashkepunimit ne fushen e mesimdhenies dhe punes studimore midis KLV dhe FEUT. Nenshkrimi i kesaj Marreveshje nepermjet vendosjes se rregullave për bashkepunim dypalesh, i sherben lehtesimit te zbatimit te funksioneve te vete institucioneve. Kjo Marreveshje Mirekuptimi perben nje hap perpara ne drejtim te permiresimit te metejshe me marredhenieve te bashkepunimit midis institucioneve brenda vendit ne fusha me interes reciprok.

Ne Prill 2002, KLV dhe FEUT me iniciativen e nje grupi studentesh te SIFE organizuan ne ambientet e FEUT nje imitim te tregtimit ne Burse. Qellimi i ketij simulimi ishte rritja e nivelit te njohurive te studenteve dhe te Komunitetit te Biznesit per ceshtje qe kane te bejne me tregjet e letrave me vlere dhe menytrat e investimit ne keto tregje. Te ftuarit ne kete aktivitet ishin personalitete ne fushen e biznesit, drejtuesit e dhomes se tregetise si dhe perfaqesues te Universitetit te Tiranes, KLV, Bankes se Shqiperise dhe drejtues se bankave me te njohura private qe operojne ne Shqiperi. Ne kuadrin e Forumit te Institucioneve Financiare brenda vendit, KLV ka bashkepunuar me institucionet pjesemarrese te ketij forumi. Keshtu gjate vitit 2002 jane organizuar takime ku jane

diskutuar ceshtje lidhur me kontabilitetin ne kuadrin e zhvillimeve te reja boterore, politikat e aplikimit te tarifave nga institucionet financiare, etj.

Ne kuadrin e marredhenieve me organizatat e ndryshme nderkombetare gjate vitit 2002 eshte punuar per plotesimin e pyetesoreve te meposhtem:

- Anketimi i Bankes Boterore, FMN, USAID mbi tregun e Instrumentave te Borxhit te Shtetit;
- Pyetesi i CONSOB-it ne lidhje me te dhenat makroekonomike te vendit dhe karakteristikat e tregut te kapitaleve ne Shqiperi;
- Pyetesi derguar nga Grupi Konsultativ mbi marrjen e paketes kontrolluese.

3.3 Grupi Konsultativ

Ne Maj 2001, me iniciativen e KE u krijua Grupi Konsultativ, nje forum konsultativ i institucioneve qe mbikqyrin tregjet e kapitalit ne vendet qe aspirojne t'i bashkohen BE. Objektivat e ketij Grupi konsistojne ne bashkepunimin midis anetareve te Grupit dhe CESR-it si dhe shteteve anetare te EU ne zbatimin e baze rregullative te EU, si dhe te kete akses ne punen rregullative aktuale brenda EU.

Komiteti European i Rregullatoreve te Letrave me Vlere (CESR), i perbere nga perfaqesues te institucioneve qe rregullojne tregjet e kapitalit ne shtetet anetare te EU, u krijua me qellim qe te keshilloje Komisionin European ne marrjen e masave per zbatimin e Direktivave, si dhe te forcoje interpretimin dhe zbatimin e baze rregullative te EU. CESR, pervec funksioneve te tij brenda kuadrit te BE, eshte ne procesin e zhvillimit te lidhjeve me vendet qe aspirojne te bashkohen ne BE.

Gjate vitit 2002, Grupi Konsultativ ka kryer aktivitetin e tij lidhur me dhenien e eksperiences ne zbatimin e rregulloreve te EU. Grupi gjithashtu ka punuar ne zbatimin e ideve te perfshira ne draft rregulloret e pergatitura nga CESR.

Komisioni i Letrave me Vlere te Shqiperise merr pjese ne mbledhjet e Grupit Konsultativ me statusin e vezhguesit. KLV, gjate vitit 2002 mori pjese ne mbledhjen e ketij Grupi te organizuar nga Komisioni Cek i Letrave me Vlere me mbeshtetjen e Komisionit Polak te Letrave me Vlere dhe Burses qe u zhvillua ne Shtator 2002 ne Republiken Ceke.

3.4 Marreveshjet e Mirekuptimit

Komisioni i Letrave me Vlere i Shqiperise hyn ne Marreveshjet e Mirekuptimit për bashkepunim dhe shkembim informacioni bazuar ne standartet e aprovuara nga IOSCO. KLV edhe gjate vitit 2002 ka punuar për te forcuar lidhjet e tij me autoritetet e ngjashme aktiviteti i te cilave eshte i lidhur me tregjet e kapitaleve ne bote, duke nxitur ne kete menyre koordinimin, shkembimin e informacionit dhe rritjen e integritetit.

Keshtu, ne Konferencen e IOSCOs qe u mbajt ne Stamboll te Turqise ne Maj 2002, Komisioni i Letrave me Vlere i Shqiperise dhe Agjensia e Tregut te Kapitaleve te Sllovenise nenshkruan nje Memorandum Mirekuptimi.

Gjate ketij viti jane pergatitur për nenshkrim drafti perfundimtar i Marreveshjes se Mirekuptimit me Komisionin Maqedon te Letrave me Vlere dhe Burses si dhe me Bordin e Tregjeve te Kapitalit te Turqise qe priten te nenshkruhen gjate vitit te ardhshem. Keto Marreveshje synojne krijimin e kuadrit per shkembimin e informacionit, lehtesimin e bashkepunimit qe eshte i rendesishem ne kushtet e globalizimit te tregjeve financiare.

Gjithashtu, ne kuadrin e Marreveshjeve te Mirekuptimit eshte punuar ne lidhje me proceduren e Marreveshjes Multilaterale te Bashkepunimit ne kuadrin e IOSCOs. Komisioni aktualisht eshte duke punuar për nenshkrimin e Marreveshjeve te Mirekuptimit me kater institucione qe mbikqyrin tregjet e kapitalit ne bote.

3.5 Asistenca Teknike

KLV ne vijim te punes se tij për forcimin e lidhjeve me institucione dhe organizata nderkombetare i ka kushtuar rendesi te vecante identifikimit te mundesive për bashkeveprim. Ne kete kuader jane pergatitur materiale informuese për FSVC, USAID, British DFDI, GTZ ne te cilat jane identifikuar nevojat aktuale te tregut te kapitaleve ne Shqiperi.

Ne Janar 2002, KLV ne bashkepunim me FSVC punuan ne organizimin e seminarit dyditor "Mbi Qeverisjen e Shoqerive Aksionere" qe u zhvillua ne Tirane.

Gjate ketij viti ne bashkepunim me OECD eshte bere e mundur pjesemarrja ne dy tavolina te rrumbullakta te organizuara nga kjo organizate ne lidhje me parimet qe duhet te udheheqin qeverisjen e Shoqerive Aksionere ne vendet e Europes Juglindore.

Ne Tetor 2002 me asistencen e GTZ u be e mundur pjesemarrja e KLV ne mbledhjen e Grupit Konsultativ qe u zhvillua ne Republiken Ceke.

3.6 Pjesemarrja e KLV ne Seminare, Konferenca e Programe Trainimi

Gjate vitit 2002 KLV ka ndjekur, ka koordinuar dhe ka marre pjese ne aktivitetet e meposhtme te organizuara nga institucione dhe organizata nderkombetare ne lidhje me tregjet e kapitaleve ne bote:

- Ne Maj 2002, KLV mori pjese ne Konferencen e 27 Vjetore te IOSCOs qe u zhvillua ne Stamboll te Turqise. Tema e Konferences se ketij viti ishte "Globalizimi: Oportunitete dhe Sfida";
- Ne Mars 2002, KLV mori pjese ne workshopin e organizuar nga OECD dhe Banka Boterore mbi "Zhvillimin e Tregjeve te Obligacioneve te Korporatave";
- Ne Prill 2002, KLV mori pjese me nje punonjes nga stafi i saj ne seminarin e organizuar nga SECu amerikan dhe Instituti Nderkombetar per Zhvillimin e Tregut te Letrave me Vlere ne SHBA;
- Ne Maj 2002, KLV mori pjese ne nje seminar me teme "Aspektet Juridike te Tregtise Elektronike dhe Tregjet Publike" organizuar nga IDLI (International Development Law Institute) qe u zhvillua ne Rome, Itali;
- Ne Maj 2002, KLV mori pjese ne Tryezen e dyte te rrumbullaket te vendeve te Europes Juglindore mbi qeverisjen e shoqerive aksionere me teme "Transparenca dhe informimi i vazhdueshem";
- Ne Shtator 2002 u zhvillua ne Prage, Republiken Ceke, Mbledhja e Grupit Konsultativ organizuar nga Komisioni Cek i Letrave me Vlere. KLV mori pjese ne kete aktivitet me statusin e vezhguesit;
- Ne Nentor 2002, KLV mori pjese ne Tryezen e Rrumbullaket te vendeve te Europes Juglindore mbi Qeverisjen e Shoqerive Aksionere me teme: pergjegjesite e Bordit dhe roli i punonjesve dhe kreditoreve ne qeverisjen e shoqerive aksionere.

3.7 Aktiviteti Publikues

KLV, gjithashtu ka vazhduar te publikoje gjate ketij viti "Periodikun KLV" qe ka dale rregullisht cdo tre muaj ne anglisht dhe ne shqip. Ky Botim ka dhene nje informacion te dobishem mbi veprimtarine e Komisionit dhe mbi zhvillimin e tregut te kapitaleve.

Temat kryesore te periodikut për vitin 2002 kane konsistuar ne:

- *Janar 2002* Kërkesa për nje Arkitekture te re financiare
- *Prill 2002* Roli dhe Potenciali i Organizates veterregulluese EMTA
- *Korrik 2002* Mbikqyrja e Tregut te Letrave me Vlere
- *Tetor 2002* Rregullimi i Tregut te Letrave me Vlere mbi Bazen e Praktikave me te mira Nderkombetare

Gjate ketij viti, KLV sipas detyres se ngarkuar me ligj ka publikuar Raportin Vjetor 2001. Keto botime, kane synuar te pasqyrojne punen e Komisionit ne drejtim te ngritjes se nje baze ligjore bashkekohore si autoritet i vetem rregullator i tregut te letrave me vlere ne vend, bazuar ne parimet e IOSCO-s dhe Direktivat e Europes qe kane si qellimin me te larte mbrojtjen e investitoreve, parandalimin e mbi-rregullimit dhe terheqjen e pjesemarresve ne treg.

4. Zhvillimi i Tregut gjate vitit 2002

Ekonomia shqiptare, si nje ekonomi ne rritje dhe me burime te kufizuara financimi, ne stadin aktual te zbatimit te nje programi ambicioz makroekonomik dhe privatizimi te potencialeve strategjike te saj, ka nevojte te zhvilloje tregun e letrave me vlere.

Bursa e Tiranes u krijua me 2 Maj 1996, si Departament i Bankes se Shqiperise, per tu shkeputur prej saj si institucion me vete pas nje periudhe tranzitore. Fillimisht, ne kete treg u menduan te tregtoheshin instrumenta te ndryshme te tregut te kapitaleve dhe atij te parase si aksionet e shoqerive te ndryshme, bonot e thesarit, obligacionet etj. Ne vitet e para, kjo burse pati nje nivel relativisht te kenaqshem transaksionesh, kryesisht ne bono thesari dhe ne obligacione te emetuara nga qeveria. Qe nga Gushti i vitit 1998, BT iu hoq edhe kryerja e ankandeve për emetimin e bonove te thesarit ne tregun primar.

Viti 2002 shenoi nje kthese ne zhvillimin e tregut te kapitaleve ne Shqiperi me shkeputjen e Burses se Tiranes (BT) nga Banka Qendrore.

Ne Mars 2002, Bursa e Tiranes u regjistrua si shoqeri aksionere ne Gjykatën e Rrethit te Tiranes me aksioner te vetem shtetin. Krijimi i Burses si shoqeri anonime i pergjigjet nivelit te zhvillimit aktual te ekonomise shqiptare, nevojtes per krijimin e nje tregu legal per shkembimin e instrumentave te ndryshem te parase dhe kapitalit, duke u mbeshtetur ne pervojen e vendeve te zhvilluara te ekonomise se tregut. Shkeputja e Burses nga Banka e Shqiperise dhe transformimi i saj ne shoqeri anonime me aksioner te vetem shtetin, do te beje te mundur qe per here te pare ne Shqiperi te krijohet nje treg letrash me vlere legal dhe i besueshem, i ndertuar mbi koncepte bashkekohore.

Ne Nentor 2002, mbeshtetur ne Rregulloren “Per Licensimin e Tregut te Letrave me Vlere”, Komisioni aprovoi dhenien e Licenses provizore BT, license e cila do t’i hape rugen procedimit te metejshem per marrjen e licenses se perhershme dhe ushtrimit te aktivitetit si treg i letrave me vlere.

Ne Tetor 2002, BT miratoi planin e veprimit te saj për nje periudhe trevjecare. Ne kete plan veprimi jane prezantuar hapat konkrete qe duhet te ndermerren, për te mundesuar

tregtimin e instrumentave perkates ne BT si dhe kerkesat administrative, teknike dhe financiare te domosdoshme për permbushjen e tyre.

Nga ana tjeter, Burses se Tiranes vazhdon t'i mungoje produkti baze - aksionet, per faktin se ne te nuk eshte kuotuar asnje aksion i ndonje shoqerie aksionere. Arsyet e kesaj mungese burojne nga mosgadishmeria e shoqerive per te listuar aksionet ne Burse, gjendja jo e larte financiare e tyre, mosdeshira per t'u kthyer ne shoqeri aksionere publike, etj. Ketu duhet patur parasysh se Bursa e Tiranes eshte e para burse ne te gjithe historikun e financave te Shqiperise, dhe mungesa e tradites dhe e eksperiences se meparshme shqiptare ne kete drejtim ka pasojat e veta.

Vazhdimi i procesit te privatizimit eshte nje potencial real per rritjen e ndjeshme te numrit te zoteruesve te aksioneve dhe rrjedhimisht dhe numrit te transaksioneve mes tyre. Zhvillimi perspektiv i Burses se Tiranes sh.a do te duhet te ece me te njehtin hap me zbatimin e programit qeveritar per ekonomine dhe privatizimin, ne menyre qe ajo te jete pjese e garantimit te suksesit te ketij programi.

Ne Nentor 2002, Komisioni i Letrave me Vlere aprovoi dhenien e Licenses si Rregjistruet i Aksioneve, Shoqerise "Qendra e Rregjistrimit te Aksioneve" sh.a. QRA-ja eshte shoqeri anonime pa oferte publike, ne te cilen te gjitha aksionet zoterohen nga shteti. Ajo u krijua si nje institucion i pavarur dhe i specializuar qe do te mbante rregjistrin e aksioneve te shoqerive private anonime te krijuara si rezultat i programit te privatizimit masiv ne Shqiperi. Te dhenat e Qendres se Regjistrimit te Aksioneve deshmojne se tregu i aksioneve ekziston, ndonese ne forme te paorganizuar. Sipas ketyre te dhenave rezulton se vetem nje numer i kufizuar i sh.a-ve nuk ka patur aktivitet tregtimi aksionesh, nderkohe qe ne shume te tjera ky aktivitet ka qene intensiv dhe eshte realizuar jashte kanaleve te tregut zyrtar te aksioneve.

Lidhja e procesit te privatizimit, dhe vecanerisht privatizimit te subjekteve te sektorit strategjik me tregun e letrave me vlere, si dhe emetimi i letrave me vlere nga subjekte te ndryshme permes ofertave publike jane hapat baze drejt nje tregu real kapitalesh.

5. Plani i Aktiviteteve te KLV gjate 2003

Drejtimet kryesore te punes se KLV gjate vitit 2003 do te jene si me poshte:

- ◆ Plotesimi dhe permiresimi i legjislacionit mbi veprimtarine investuese ne letrat me vlere. Do te punohet per pergatitjen e akteve nenligjore te ligjit "Per Letrat me Vlere". Do te pergatiten rregulloret "Për Licensimin e Keshilltarit te Investimeve", "Për Licensimin e Depozitarit", "Për parandalimin e tregtimit te paligjshem", "Për Monitorimin e te Licensuarve" si dhe do te plotesohet kuadri ligjor për te gjithë operatorët ne treg. Do te vazhdoje puna për miratimin e akteve nenligjore te projekt ligjit "Mbi Investimet Kolektive ne Fondet e Letrave me Vlere".
- ◆ Ndjekja e strategjise se zhvillimit te tregut te kapitaleve ne Shqiperi. Me aprovimin nga KLV te dhenies se Licenses provizore Burses, Komisioni do te punoje per ndjekjen e procedurave te licensimit perfundimtar te Burses.
- ◆ Nje vemendje e vecante do te vazhdoje t'i kushtohet punes ne sektorin e marredhenieeve nderkombetare. Do te vazhdohet puna ne drejtim te bashkepunimit me IOSCO-n, ne drejtim te zbatimit te parimeve te kesaj organizate, te ndjekjes se aktiviteteve te saj si dhe informacionit, rezolutave e dokumentave qe dalin nga kjo organizate. Gjithashtu do te vazhdoje puna ne drejtim te bashkepunimit me Grupin Konsultativ, Iniciativen e vendeve te Europes Juglindore si dhe do te punohet ne drejtim te nenshkrimit te Marreveshjeve te Mirekuptimit me rregullatore te tjere te tregjeve te kapitalit.
- ◆ Me licensimin perfundimtar te Bursa Tirana sh.a, mbikqyrja e tregut, duke perfshire edhe sistemet e mekanizmat e pastrimit dhe rregullimit te transaksioneve do te perbeje nje nga drejtimet e punes se KLV, për te siguruar se aktiviteti, praktikat dhe drejtimi i veprimtarise investuese ne letrat me vlere eshte ne interes te publikut.
- ◆ Do te vazhdohet puna ne pergatitjen e workshopeve te ndryshme qe synojne studimin e potencialit te zhvillimit te tregut te letrave me vlere ne Shqiperi. Gjithashtu do te punohet per pergatitjen e materialeve informuese qe synojne ndihmesen ne zgjerimin e njohurive te investitoreve ne percaktimin e synimeve te investimit dhe parashikimin e te ardhmes prej tyre.

6. Buxheti i KLV ne vitin 2002

KLV ne mbeshtetje te ligjit Nr.8080, Dt. 01.03.1996, "Per Letrat me Vlere", neni 13, financohet nga Buxheti i Shtetit me subvencion për një periudhë kohe derisa të funksionojë si institucion i pavarur ku pagimi i kuotave apo detyrimeve të tjera ndaj Komisionit do të jenë të mjaftueshme për funksionimin e tij.

Kontabiliteti i Komisionit te Letrave me Vlere eshte mbajtur ne perputhje me planin e ri kontabel "Per Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shteterore Qendrore dhe Lokale si dhe Njesite qe varen prej tyre", miratuar nga Keshilli i Ministrave me VKM Nr. 248, Dt. 10.04.1998 ne zbatim te Ligjit Nr.7661, Dt. 19.01.1993 "Per Kontabilitetin" dhe ne mbeshtetje te Planit te Pergjithshem Kontabel te miratuar me VKM nr. 334, Dt. 09.07.1993. Per mbajtjen e kontabilitetit perdoren si menyra manuale ashtu edhe e kompjuterizuar me ane te programit te kontabilitetit "ALPHA".

BURIMET BUXHETORE DHE PERDORIMI I TYRE

	Plani	Fakti
Subvencion per funksionimin	17,500,000	17,405,430.5
Financim nga buxheti per investime	1,500,000	288,350
Totali	19,000,000	17,693,780.5


FONDET E VETA

Te ardhurat ne 2002	738,500
Te ardhura te trashaguara	3,726
Totali i te ardhurave	742,226
Shpenzuar nga te ardhurat	500,676
Teprica ne mbyllje	241,550


SHTOJCA*

Yieldi i Bonove te Thesarit krahasuar me normen e depozitave dhe Inflacionin për vitin 2002


3 mujore			
	B.TH	Depozita	inflacioni
Janar	7.99	6.93	1.53
Shkurt	7.99	6.90	-0.21
Mars	8.00	6.90	0.15
Prill	8.77	7.00	-0.10
Maj	9.61	7.30	-1.63
Qershor	9.80	7.70	-1.48
Korrik	9.79	8.00	-0.70
Gusht	9.79	7.90	0.19
Shtator	10.30	7.90	0.96
Tetor	10.30	8.00	0.21
Nent	10.60	7.90	0.02
Dhjetor	11.07	8.00	3.23



6 mujore			
	B.TH	Depozita	inflacioni
Janar	9.79	7.37	1.53
Shkurt	9.79	7.30	-0.21
Mars	9.78	7.40	0.15
Prill	10.53	7.40	-0.10
Maj	11.21	7.80	-1.63
Qershor	11.21	8.00	-1.48
Korrik	11.27	8.20	-0.70
Gusht	11.22	8.30	0.19
Shtator	11.69	8.50	0.96
Tetor	11.84	8.80	0.21
Nentor	12.01	8.90	0.02
Dhjetor	12.03	8.90	3.23




12 mujore			
	B.TH	Depozita	inflacioni
Janar	10.49	7.76	1.53
Shkurt	10.40	7.70	-0.23
Mars	10.40	7.80	0.15
Prill	11.22	7.80	-0.10
Maj	11.79	8.60	-1.63
Qershor	11.78	8.60	-1.48
Korrik	11.51	8.70	-0.70
Gusht	11.79	8.80	0.19
Shtator	12.20	8.90	0.96
Tetor	12.40	9.20	0.21
Nentor	12.54	9.30	0.02
Dhjetor	12.61	9.30	3.23



- te dhenat per shtojcen: Banka e Shqiperise

Yieldi per Bonot e Thesarit 2002			
Ne perqindje			
	3 mujore	6 mujore	12 mujor
January	7.99	9.79	10.49
February	7.99	9.79	10.49
March	8.00	9.78	10.49
April	8.77	10.53	11.22
May	9.61	11.21	11.79
June	9.80	11.21	11.78
July	9.79	11.27	11.51
August	9.79	11.22	11.79
Septemb	10.30	11.69	12.20
October	10.30	11.84	12.40
Novem	10.60	12.01	12.54
Decem	11.07	12.03	12.61



Portofoli TB ne dt.31.12.2002

BANKAT	Ne vlere nominale (leke)
--------	--------------------------

B.Shqiperise	76,068
B.Kursimit	142,830
B.Komb. Tregtare	17,943
Internat. Com. Bank	295
B.Alpha	684
Tirana Bank	9,058
B.Kombetare Greke	1640
B.Italo-Shqiptare	2647
B.Dardania	32
B.Amerikane	5878
Fefad Bank	2670
First Invest. Bank	80
B.Tregtare Greke	656
INSIG	1685
ISKSH	1202
ISSH	4597
Intersig sh.a	75
Fondacionet	478
Inst. Te tjera	50
Individe	7841

Burimi: Banka e Shqiperise

Treguesit Ekonomike											
	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002
Prodhimi dhe Shpenzimet	(ndryshimi ne perqindje)										
Rritja e PPB	-7.2	10.0	8.3	13.3	9.1	-10.3	12.70	8.8	7.7	6.5	4.70*
Prodhimi industrial	-51.2	-10.0	-2.0	6.0	13.6	-5.6	4.1	6.4	5	6.5	2.0
Prodhimi bujqesor	18.5	10.4	8.3	13.2	3.0	1.0	5.0	3.7	4.5	1.4	2.1
Ndertimi	7.0	30.0	15.0	21.0	8	18	-6.3	21	15.0	17.0	14
Transporti	-15.0	-13.0	18.0	19.0	-1.0	-20.5	20.0	15.0	14.0	13	10.1
IÇK(1Ndryshimi 12 mujor ne %)	236.6	31.0	16.0	6.0	17.4	42.0	8.7	-1	4.2	3.5	2.1
Pagat mesatare mujore (sektori publik) (000 leke)	NA	3084	4778	6046	8638	9558	11509	12708	1489	17218	19574
Paraja gjithsej-M3 (fundi i vitit) (mln leke)	28771	50355	70775	107449	154552	198547	239526	292871	328101	394316	416685
Paraja jashte bankave (mln leke)	9897	17990	27627	41906	47815	72726	68323	81336	99236	119091	130776
	(Ne milione leke)										
Kreditit i brendshem	31773	80248	94525	85112	126063	180305	207937	230554	24717	266479	303765
Pretendime ndaj Qeverise	20234	73343	84839	73673	111759	164470	187814	212041	224476	238538	256432
Pretendime ndaj nd. Publike jofinaciare	10164	2444	2485	3093	3414	2898	2830	1671	1053	547	1161
Pretendime ndaj sektorit privat	1375	4462	7201	8347	10890	13007	13485	16841	22189	27394	46172
	(Ne perqindje ndaj PPB)										
Te ardhurat buxhetore	22.8	26.7	24.1	23.4	18.4	16.6	20.5	20.6	22.4	22.9	22.9
Totli i Deficitit	-58.6	-13.7	-9.0	-10.2	-12.8	-12.9	10.4	-11.0	-9.3	-8.6	-6.2
Shpenzimet buxhetore	81.4	40.4	33.1	33.6	31.2	29.5	30.7	32.7	31.6	31.5	29.1
Borxhi i Jashtem	90.3	41.1	179.7	261.4	323.5	347.5	460.5	550.1	616.9	697.7	978.4
Te dhena mbi bilancin e pagesave	(ne milion USD)										
Llogaria Korente	-50.8	14.7	31.2	36.7	-62.4	-253.7	-45.2	-132.9	-163.1	-218.5	-447.6
Transfeta Private	150.0	324.1	374.1	349.0	476.0	236.0	437.7	188.4	438.6	542.7	606.8
Transferta Shtetore	374.0	280.0	117.0	129.0	84.0	29.0	82.6	16.5	94.4	28.1	38.2
Bilanci Tregtar	-470.0	-490.0	-460.0	-475.0	-678.0	-535.0	-603.7	-662.8	-814.3	-1026.9	-1155.2
	(Per jave importi)										
Reserva (perjshtuar arin)	3.3	12.8	4.1	4.2	3.6	5.3	5.7	5.7	29.4	28.9	18.4
Tregues te ndryshem											
Popullsia (ne milion)	3.2	3.2	3.2	3.2	3.3	3.35	3.35	3.37	3.4	3	3
Papunesia (ndryshimi ne %,mesatare vjetore)	-27.8	-7.8	-6.4	0.35	-7.3	22.7	21.1	2.1	-10.5	-16	
Norma e papunesise (ne% te forces te punes)	30.3	22.3	18.4	13.0	12.4	14.9	17.8	18.2	16.8	14.6	16
PPB (ne milion Leke)	49517	125334	184400	22979	29100	341716	480631	506205	539210	590237	658062
Prodhimi bujqesor ne % te PPB	54.0	56.0	56.0	56.0	52.8	56.0	54.4	52.6	35.9	34.2	33.3
Prodhimi industrial ne % te PPB	17.0	14.0	13.0	11.7	12.5	12.4	11.9	11.9	13.2	13.2	12.8
Kursi i Kembimit (Leke per USD, mes. vjetore)	75.0	102.0	94.7	92.8	104.5	148.9	150.6	137.69	143.71	143.48	133.74
Norma e interesit (huadhenia,12 m. maturimi, fundi i vitit)	39.0	30.0	20.0	21.0	28.8	43.0	25.0	25.8	23.7	11.9	16.0
	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	
Depozitat	(ndryshimi vjetor ne %)										
Totali i depozitave	71.5	33.3	52.7	64.5	24.8	36.2	23.6	8.2	20.3	8.0	
Depozita pa afat	43.9	7	60.9	158	-49.6	-17.2	40.7	14.5	-3.9	-5.6	
Depozita me afat	145.7	59.8	49.9	21.5	110.3	60.7	183	2.8	15.5	7.2	
Foreign exchange deposits	49.8	29.8	50.9	54.4	13.4	10.7	32.2	19.5	40.1	13.5	
Normat e interesit	(fundi i periudhes, vjetore ne %)										
Perqindja e rifinancimit	...	25.0	20.5	24.0	32.0	22.9	17.8	10.8	-	-	
Perqindjet e depozitave -12 m	...	16.5	13.7	19.1	27.8	16.5	9.1	7.7	7.8	9.3	
Perqindja e Kredise - 12 m	...	20.0	21.0	28.8	43.0	25.0	25.8	23.7	11.9	16.0	
Bono Thesari - 3 m	...	...	14.7	21.1	35.3	19.9	14.8	7.8	8	11.2	
Bono Thesari - 6 m	...	...	14.9	22.3	34.5	21.5	15.5	11.3	9.8	12.0	
Bono Thesari -12 m	...	...	15.1	22.5	35.0	23.0	15.8	12.3	10.5	12.6	

Burimi: Ministria e Finances, Banka e Shqiperise, INSTAT